

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2010

LËNDA: NJOHURI PËR SHOQËRINË

VARIANTI **A**

E mërkurë, 30 qershor 2010

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Studioni situatën dhe përgjigjuni pyetjeve 1, 2, 3 që lidhen me të:

Tashmë vendimi kishte marrë formë të prerë. Me babain nuk mund të fliste as nëna. Motra e vogël qante, por nuk dukej shumë e mërzhitur. Ndoshta ishin lotë nostalgjie për ndarjen prej nesh. Në familjen tonë urdhëri i babait nuk ishte diskutuar ndonjëherë. I ashpër në dukje, por vendimet e tij ishin shpirtmira.

Në dhomën e pritjes njerëzit qeshnin e gëzonin. Dasëm ishte dhe gjithshka dukej bukur. Një grua ishte veshur sikur do të shkonte të blinte diçka. Dallohej lehtësisht prej të tjerëve. Që nga vendi ku isha ulur pashë nënën që i bëri një shenjë dhe gruaja u largua. Mendova mos u fye. Nuk kaloi shumë dhe ajo u kthye e veshur si për festë. Hareja vazhdoi deri në mesnatë. Fqinji ynë i ri vinte nga një krahinë tjetër. Ai u befasua, u hutua nga mënyra si e organizonim dhe festonim në një ceremoni të tillë.

1. Familja e mësipërme është: 1 pikë
  - A) moderne
  - B) e hapur
  - C) patriarkale
  - D) e mbyllur
  
2. Çfarë elementi kulturor vihet re në fjalët: "...e pashë nënën që i bëri një shenjë dhe gruaja u largua..." 1 pikë
  - A) vlerë kulturore
  - B) simbol kulturor
  - C) normë kulturore urdhëruese
  - D) normë kulturore ndaluese
  
3. Si quhet gjendja e fqinjët të ri në studimet sociologjike? 1 pikë
  - A) shok kulturor
  - B) etnocentrizëm
  - C) ksenocentrizëm
  - D) relativizëm kulturor
  
4. Tregoni: 3 pikë
  - a) si përcaktohet në sociologji difuzioni kulturor \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - b) një nga ligjësitë e difuzionit kulturor \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - c) një nga aspektet ku gjuha e shkruar ka dhënë më shumë ndihmesë \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  
5. Si përkufizohen në sociologji: 3 pikë
  - a) nënkulturat \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - b) kundërkulturat \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - c) moret \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  
6. Në studimet sociologjike për fenë: 3 pikë
  - a) çfarë është dinominejshën \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - b) ç'është sekt i fetar \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
  - c) si quhej feja myslimane në Shqipëri në fillimet e përhapjes së saj nga turqit \_\_\_\_\_

7. Argumentoni interpretimet sociologjike të këtyre aspekteve të divorcit: **4 pikë**
- a) divorci emocional \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- b) divorci bashkëprindëror \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- c) divorci shoqëror \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- d) divorci psikologjik \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
8. Në komunikimin masiv anëtarët e auditorit veçohen nga njëri-tjetri dhe nga auditorët e tjerë: **1 pikë**
- A) jo vetëm në kohë e hapësirë, por edhe emocionalisht e psikologjikisht  
 B) vetëm në kohë e hapësirë, por jo emocionalisht e psikologjikisht  
 C) jo në kohë e hapësirë, por emocionalisht e psikologjikisht  
 D) nuk janë të ndarë në asnjë drejtim nga të sipërpërmendurit
9. Ndër agjencitë shoqërizuese, njësia e parë me organizim burokratik është: **1 pikë**
- A) opinioni publik  
 B) familja  
 C) shkolla  
 D) mjetet e komunikimit masiv
10. Cili nga pohimet e mëposhtëm për teknologjinë NUK është i vërtetë? **1 pikë**
- A) Ajo ka ndikim të madh në jetën e përditshme të njerëzve.  
 B) Ajo ndihmon shumë në zhvillimin e profesioneve të reja.  
 C) Ajo nuk është shumë e vlefshme për disa grupe të veçanta.  
 D) Ajo nënkupton shfrytëzimin e mjedisit.
11. Çfarë ndikon në karrierën deviante: **1 pikë**
- A) devianca parësore  
 B) nofka përcëmuese  
 C) devianca dytësore  
 D) të gjitha alternativat e mësipërme
12. Shpjegoni funksionin e deviancës si: **4 pikë**
- a) pohim i vlerave kulturore \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- b) forcim i unitetit shoqëror \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- c) përcaktim i kufijve moralë \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
- d) burim ndryshimesh shoqërore \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

13. Shpjegoni teorinë maltusiane të rritjes së popullsisë:

2 pikë

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

14. Në format e organizimit shoqëror që quhen shoqata, njerëzit:

1 pikë

- A) motivohen më shumë nga dëshira për mbarëvajtjen e anëtarëve të tjerë se nga interesa vetjake
- B) kanë solidarësi të fortë bazuar në tradita
- C) kanë solidarësi të fortë bazuar në lidhjet personale
- D) motivohen më shumë nga interesa vetjake se nga dëshira për mbarëvajtjen e anëtarëve të tjerë

15. Studioni situatën e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjes lidhur me të.

Një emigrant legal shqiptar në një vend fqinjë ishte i papunë. Autoritetet lokale i njihnin mirë aftësitë e tij intelektuale dhe profesionale. Kur u shpall konkursi për vende të lira pune nga këto autoritete ai aplikoi në tre vende për të dhënë më të mirën e tij të mundshme. Nëpunësi i parë nuk e pranoi kërkesën e emigrantit shqiptar duke pranuar në atë vend pune, një tjetër, më pak të aftë se shqiptari. Nëpunësi i dytë ishte në dilemë, por i dha përgjigje pozitive. Nëpunësi i tretë e lajmëroi të fillonte punë në institucionin e tij.

- Si e cilëson analiza sociologjike e paragjyqimeve dhe diskriminimeve (R. Merton), qëndrimin e nëpunësit: **3 pikë**

- a) të parë \_\_\_\_\_
- b) të dytë \_\_\_\_\_
- c) të tretë \_\_\_\_\_

16. Ndryshimi i mënyrës së jetesës së anëtarëve të pakicave për t'iu përshtatur modeleve të kulturës sunduese në shoqëri, në studimet sociologjike quhet:

1 pikë

- A) veçim
- B) asimilim
- C) pluralizëm
- D) shfarosje

17. Kuvendet, gjykatat dhe mitingjet janë formë e:

1 pikë

- A) debatit publik
- B) debatit jopublik
- C) organizimit të politikave publike
- D) organizimit të politikave jopublike

18. Në një sistem politik, çfarë përfaqësojnë:

2 pikë

- a) funksioni ekzekutiv (qeveria) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) funksioni gjyqësor \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

19. Disa nga faktorët që mund ta ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë lidhen me tiparet e shoqërisë si një e tërë. Përshkruani për secilin faktor një nga karakteristikat që çon drejt demokracisë:

3 pikë

- a) politika dhe vlera shoqërore që nxisin garën paqësore të ideve dhe programeve politike brenda kufijve moralë e institucionalë \_\_\_\_\_
- b) struktura shoqërore \_\_\_\_\_
- c) qëndrime shoqërore \_\_\_\_\_

20. Çfarë përfshin kriteri që lidhet me funksionimin dhe efektivitetin për vlerësimin e institucioneve demokratike përveç realizimit të rezultateve të planifikuara dhe të kënaqshme:

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_